

STUDIMI I PARË RRETH KOSTOS GLOBALE TË DHUNËS

Dhuna familjare vret më shumë njerëz se luftërat

OSLO, 9 SHTATOR (REUTERS) – Dhuna familjare, kryesisht kundër grave dhe fëmijëve, vret shumë më tepër njerëz sesa luftërat, por shpesh shpërfilllet, derisa ekonomisë botërore i kushton më shumë se tetë bilionë dollarë në vit, kanë thënë ekspertët të martën.

Studimi, për të cilën autorët kanë thënë se ishte përpjekja e parë për të dhënë vlerësim rreth kostos globale të dhunës, i bën thirrje Organizatës së Kombeve të Bashkuara që t'u kushtojnë më shumë vëmendje abuzimeve në familje, gjë kjo që vret më shumë njerëz, sesa konfliktet e armatosura prej Sirisë e deri në Ukrainë.

“Për secilën vdekje në fushëbetejë, afërsisht nëntë persona... vriten në konteste ndërpersonale”, ka thënë Anke Hoeffler e Universitetit të Oxfordit dhe James Fearon i Universitetit të Stanfordit.

Prej dhunës familjare e deri tek luftërat, autorët kanë vlerësuar se



dhuna në mbarë botën e dëmton ekonominë për 9.5 miliardë euro në vit, kryesisht në formën e prodhimit të humbur ekonomik, një shumë kjo e barasvlershme me 11.2 për qind të GDB-së botërore.

Gjatë viteve të kaluara, rreth 20-25 shtete kanë përjetuar luftëra

civile, duke shkatërruar shumë ekonomi lokale dhe duke kushtuar 170 miliardë dollarë në vit.

Megjithatë, kjo shifër mbetet e papërfillshme, krahasuar më tetë miliardë dollarë, sa është kostoja vjetore e dhunës familjare, kryesisht kundër grave dhe fëmijëve.

Në studim thuhet se 290 milionë fëmijë pësojnë nga disiplina e dhunshme në familje, sipas vlerësimeve të marra nga të dhënat e Fondit për Fëmijë të OKB-së, UNICEF.

Bjorn Lomborg, drejtuesi i Qendrës në Kopenhagë për Regjistrime, që e ka autorizuar raportin, ka thënë se dhuna familjare shpesh shpërfilllet, njëjtë sikur që aksidentet automobilistike tërheqin më pak vëmendje, sesa aksidentet ajrore, ndonëse këto të parat vrasin më shumë njerëz.

“Kjo nuk ka vetëm të bëjë me thënien ‘është problem i madh’”, i ka thënë Reutersit. “Është pikë, prej nga duhet të nisët gjetja e zgjidhjeve”. Qendra mbledh më shumë se 50 ekonomistë, përfshirë tre laureatë të “Nobelit” dhe humlton mënyrat efektive dhe më pak të kushtueshme për të luftuar gjithçka, prej ndryshimeve klimatike, e deri tek malaria.